VENDIM
Nr.351, datë 1.6.2004

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.378, DATË 12.8.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PËRFAQËSUESIT TË PRONARIT PËR DISA OBJEKTE, PRONË PUBLIKE, ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.7926, datë 10.5.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.378, datë 12.8.1999 të Këshillit të Ministrave, të bëhet kjo shtesë:

- Në listën e objekteve për kalimin e së drejtës së pronësisë organeve të qeverisjes vendore të shtohen objektet sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Objektet, që u kalojnë në pronësi organeve të qeverisjes vendore, të përdoren sipas destinacionit, të përcaktuar në listën e përmendur në pikën 1.

3. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës, Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit dhe kryetarët e bashkive të Durrësit, Fierit, Vlorës dhe Kukësit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LISTA E OBJEKTEVE PËR KALIMIN E TË DREJTËS SË PRONËSISË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE

Nr.	Objekti	Subjekti që e administron	Vendodhja e Objektit	Vartësia administrative	Kolon në Pronësi	Destinacioni i Përdorimit
1	Ndërtesa e magazinës dhe administratës, Durrës	Albbakër sh.a. Tiranë,	Durrës	Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës	Bashkisë Durrës	Për fond banese
2	Kapanoni i parkimit të makinave-Durrës	Albbakër sh.a. Tiranë,	Durrës	Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës	Bashkisë Durrës	Për fond banese
3	Ndërtesat e repartit mekanik Durrës	Albbakër sh.a. Tiranë,	Durrës	Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës	Bashkisë Durrës	Për fond banese
4	Ngrehinë mence, Vlorë	Servcom sh.a. Fier	Vlorë	Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës	Bashkisë Vlorë	Për fond banese
5	Hotel i ri, Kukës	Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit	Kukës	Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit	Bashkisë Kukës	Zyra për administratën
6	Fabrika e re e miellit, Fier	Drejtoria e Bujqësisë dhe e Ushqimit	Fier	Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit	Bashkisë Fier	Ndërtime banesash Për të pastrehët